

**Në Emër të Popullit**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS** në kolegjin e përbërë nga:  
Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit për të mitur,  
Gjyqtari i EULEX-it Lars Dahlstedt,  
Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Marije Ademi,  
Gjyqtari i Gjykatës Supreme Shukri Sylejmani dhe  
Gjyqtari i Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,

Në lëndën penale kundër

EB

Të pandehurit të mitur

I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin P. nr. 164/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 8 shkurt 2011 për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje të **Vrasjes së Rëndë**, në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 7 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës ( tash e tutje: KPK); dhe **Mbajtja Në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve** nga neni 328 paragrafi 2 të KPK-së prandaj edhe është dënuar me dënim unik me nëntë (9) vjet burgim;

Duke vendosur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar me 16 mars 2011 nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të të pandehurit të mitur kundër

Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 164/2010, të datës 8 shkurt 2011 dhe

Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pn. nr. 102/2011, të datës 25 shkurt 2011, duke vërtetuar aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut në Prizren mbi vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit të mitur,

Merr këtë

## AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 16 mars 2011 në emër të të pandehurit të mitur pranohet pjesërisht. Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 164/2010, i datës 8 shkurt 2011 në formën e aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pn. Nr. 102/2011, të datës 25 shkurt 2011 ndryshohet si në vijim:

Paraburgimi kundër të miturit [REDACTED] <sup>EB</sup> ndërpritet dhe zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak në vendbanimin e tij në fshatin [REDACTED] deri sa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P. Nr. 164/2010, i datës 8 shkurt 2011 të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se skadimi i dënimit në këtë aktgjykim.

Sa i përket pjesës së mbetur, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë refuzohet si e pabazuar dhe aktvendimi vërtetohet.

### Arsyetimi

#### I. Historia e Procedurës

(1) Më 07 prill 2010, i pandehuri i mitur [REDACTED] <sup>EB</sup> është arrestuar dhe është paraburgosur nën pretendimin e pjesëmarrjes si bashkekryerës në veprën penale Vrasje e rëndë sipas nenit 147 pikës 7 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 i KPK-së, të kryer më 16 maj 2009 rreth orës 18:00 në Bastoren Toto Sport në rrugën Esat Haskuka në Prizren, ku viktimat [REDACTED] <sup>BV</sup> është qëlluar me një plumb në pjesën e prapme të kokës nga afërsia dhe më vonë ka vdekur si pasojë e lëndimeve të marra.

(2) Më 6 shtator 2010 Prokurori Publik i Qarkut në Prizren paraqiti një aktakuzë (PP nr. 92/10) kundër [REDACTED] <sup>LB</sup> dhe një Propozim për Dënim (PPM nr. 09/10) kundër të miturit [REDACTED] <sup>EB</sup> për veprat penale Vrasje të rëndë në bashkëkryerje nga Neni 147 paragrafi 7 lidhur me Nenin 23 të KPK-së, dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga Neni 328 paragrafi 2 i KPK-së.

(3) Më 25 tetor 2010, kolegji për të mitur i Gjykatës së Qarkut në Prizren pranoi kërkesën e prokurorit për bashkimin e procedurës, duke vendosur për të mbajtur një procedurë të përbashkët dhe për të lëshuar një aktgjykim të vetëm me numër të regjistrimit P.nr.164/10.

(4) Më 04 nëntor 2010, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it duke u bazuar në Nenin 3.3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-ti (tash e tutje: LmK) vendosi të marrë këtë lëndë dhe t'ua caktojë këtë lëndë Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

EB

(5) Më 08 shkurt 2011 Gjykata e Qarkut në Prizren pas përfundimit të gjykimit shpalli të miturin [redacted] fajtor për kryerje të veprave penale Vrasje të rëndë në bashkëkryerje nga Neni 147 paragrafi 7 lidhur me Nenin 23 të KPK-së, dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga Neni 328 paragrafi 2 i KPK-së. Në përputhje me Nenin 71 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, Gjykata i shqiptoi të pandehurit të mitur një dënim unik me nëntë (9) vjet burgim.

(6) Gjithashtu, më 8 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren, të pandehurit të mitur ia ka vazhduar paraburgimin me anë të një aktvendimi të ndarë P.Nr. 164/10, derisa aktgjykimi i shkallës së parë të bëhet i formës së prerë.

EB

HK

(7) Më 16 shkurt 2011, avokati mbrojtës [redacted] në emër të të pandehurit të mitur [redacted] ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren të datës 8 shkurt 2011 (P.Nr. 164/10), duke e kundërshtuar atë për shkelje esenciale të ligjit të procedurës, në veçanti shkelje të nenit 281 paragrafëve 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje KPPK). Mbrojtja i ka propozuar gjykatës shqiptimin e masave tjera alternative sipas nenit 268 të KPPK-së, mirëpo kjo është kundërshtuar me mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (tani e tutje ZPShK), të datës 25 shkurt 2011.

(8) Më 25 shkurt 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka lëshuar aktvendimin Pn.-Kr. Nr. 102/11, duke e refuzuar ankesën e avokatit mbrojtës si të pabazuar dhe duke e vërtetuar aktvendimin e Gjykatës së Qarkut.

(9) Më 16 mars 2011, avokati mbrojtës në emër të të pandehurit të mitur ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër aktvendimi të Gjykatës Supreme të Kosovës Pn.-Kr. Nr. 102/11, të datës 25 shkurt 2011, dhe aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P. Nr.164/2010, të datës 08 shkurt 2011, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale

(10) Më 30 mars 2011, ZPShK-ja ka dorëzuar mendimin në Gjykatën Supreme të Kosovës duke propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar

## II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

### 1. **Pranueshmëria e Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë**

(11) Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pranueshme. Është paraqitur pranë gjykatës kompetente sipas neneve 451 dhe 453 të KPPK-së dhe brenda afatit ligjor të nenit 452 paragrafit 3 të KPPK-së

## 2. Procedurat e zbatuara nga Gjykata Supreme

(12) Gjykata Supreme ka vendosur në seancë sipas nenit 454 paragrafit 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar për seancën, pasi që sipas nenit 451 deri në nenin 460 të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është e obliguar që t'i njoftoj palët.

## 3. Lidhur me meritat e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

(13) Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar.

Avokati mbrojtës ka kundërshtuar aktvendimin e Gjykatës Supreme si të paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin. Sipas parashtrësës së tij, aktvendimi nuk përputhet me dispozitivin e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut. Për më tepër, Gjykata Supreme duke e refuzuar ankesën e mbrojtjes kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, kishte shkelur Nenin 68, par. 2 të Kodit Penal për të Mitur (KPM), i cili kufizon kohëzgjatjen maksimale të paraburgimit për të miturit deri në 12 muaj. Prandaj, theksohet shkelja e Nenit 403, par. 1, pikës 12 të KPPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se dispozitivi i Aktvendimit Pn. Kr. 102/2011 i Gjykatës Supreme të Kosovës nuk përputhet me arsyet kur vërteton aktvendimin e shkallës së parë, i cili kishte vazhduar paraburgimin kundër të pandehurit të mitur "... derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë... "... "pa përcaktuar një fund të qartë.

Gjykata konstaton se Neni 68, par. 2 i Kodit Penal për të Mitur, kodit nr. 03/L-193, të botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës, të vitit V / Nr. 78, të datës 20 gusht 2010 (tash e tutje KPM), cakton një kufi absolut për kohën e kaluar në paraburgim nga i mituri. Për këtë arsye, çdo aktvendim që cakton apo vazhdon paraburgimin ndaj një të pandehuri të mitur duhet që të respektojë kufizimin e përmendur dhe duhet të përmbajë një fund të fiksuar dhe të parashikueshëm i cili do të shënojë fundin e kësaj mase. Formulimi i përdorur nga ana e Gjykatës së Qarkut nuk përmbush këtë standard pasi që momenti kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë nuk mund të parashikohet me saktësi.

Për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës ka gabuar kur pretendon se dispozita e Nenit 68, par. 2 i KPM-së ka qenë jomeritor pasi që afati i përcaktuar kohor për paraburgimin nuk kishte skaduar akoma. Formulimi i dispozitivit në aktvendimin e shkallës së parë domosdoshmërisht do të shpinte në situatën kur i pandehuri të mbahet përtej afatit kohor të përcaktuar me ligj.

(14) Gjykata gjen se vazhdimi i paraburgimit deri në masën e lejuar me nenin 68 paragrafin 2 të LPMK-së ka qenë i bazuar dhe për këtë arsye e ka pranuar pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në arsyetimin përkatës të saj, Gjykata Supreme ka theksuar se të gjitha kushtet e nenit 281 paragrafit 1 nënparagrafëve 1 dhe 2, pikave (i) dhe (iii) të KPPK-së janë përmbushur për të pandehurin [REDACTED]. Sa i përket kushteve të dyshimit të bazuar, Gjykata Supreme i është referuar aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren (P.nr. 164/2010) të datës 08 shkurt 2011, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje sipas nenit 147 paragrafit 7 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të

KPK-së. Gjykata Supreme në këtë kontekst ka theksuar në mënyrë të qartë se pajtim me gjykimin e përhershëm të Gjykatës Supreme siç është shprehur në lëndën Pn-Kr. 239.10 të datës 4 qershor 2010, se dyshimi i bazuar është i mjaftueshëm për qëllimet e nenit 281 të KPPK-së dhe se në këtë fazë të procedurës se nuk nevojitet asnjë provë përfundimtare se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin ai akuzohet

Gjykata Supreme ka theksuar qartë se për shkak të "... vetë faktit që i pandehuri është shpallur fajtorë në shkallën e parë, aktvendimi i ankimuar për vazhdimin e paraburgimit nuk përmban gabime sa i përket dyshimit të bazuar sipas nenit 281 paragrafit 1 të KPPK-së ". Prandaj, Gjykata Supreme gjithashtu e ka bërë të qartë se për shkak të dënimit ekziston rreziku i pakontestuar i arratisjes për të pandehurin.

Si rrjedhojë, gjykata konstaton se kushtet e nenit 278 paragrafit 1 të KPPK-së për shqiptimin e masës alternative të arrestit janë përmbushur.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**PKL.-KZZ. Nr. 30-2011**  
**19 prill 2011**

**Anëtarët e kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
**Marije Ademi**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

\_\_\_\_\_  
**Salih Toplica**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

\_\_\_\_\_  
**Shukri Sylejmani**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

\_\_\_\_\_  
**Lars Dahlstedt**  
Gjyqtar i EULEX-it

**Kryetar i kolegjit:**

**Procesmbajtës:**

\_\_\_\_\_  
**Gerrit-Marc Sprenger**  
Gjyqtar i EULEX-it

Republika e Kosovës



Republika e Kosovës

\_\_\_\_\_  
**Holger Engelmann**  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik